


# PASQYRIMI I POTËNCIALIT PËR INTEGRIMIN KONSTRUKTIV TË SERBEVE TË KOSOVËS NË ARSIM, SHËNDETËSI, EKONOMI DHE TRASHËGIMI KULTURORE





# Pasqyrimi i potencialit për integrimin konstruktiv të serbëve të Kosovës në arsim, shëndetësi, ekonomi dhe trashëgimi kulturore

**Publikuar nga:**

New Social Initiative - NSI  
Kosovar Centre for Security Studies - KCSS

**Autorët:**

Ramadan Ilazi  
Aleksandar Šljuka

Dhjetor 2024

Opinionet e shprehura në këtë publikim nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht ato të Balkan Trust for Democracy, Fondit Gjerman Marshall të SHBA-së, USAID-it apo Qeverisë së SHBA-së.



# Tabela e përbajtjes

<b>PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE .....</b>	<b>6</b>
<b>O1 HYRJE.....</b>	<b>8</b>
<b>O2 SHQYRTIMI I GJENDJES SË TANISHME NË ARSIM, SHËNDETËSI, TRASHËGIMI KULTURORE DHE EKONOMI .....</b>	<b>10</b>
2.1 Education.....	10
2.2 Shëndetësia .....	12
2.3 Trashëgimia kulturore .....	12
2.4 Ekonomia .....	13
<b>O3 NJË VËSHTRIM MË I AFËRT MBI SFIDAT PËR INTEGRIMIN KONSTRUKTIV NË ARSIM, SHËNDETËSI, TRASHËGIMI KULTURORE DHE EKONOMI .....</b>	<b>15</b>
3.1 Arsimi .....	15
3.2 Shëndetësia .....	17
3.3 Trashëgimia Kulturore .....	18
3.4 Ekonomia .....	20
<b>O4 FUSHAT ME POTENCIAL PËR TË AVANCUAR ME INTEGRIM KONSTRUKTIV .....</b>	<b>22</b>
4.1 Trashëgimia Kulturore dhe Fetare .....	22
4.2 Integrimi Ekonomik .....	22
4.3 Arsimi .....	23
4.4 Shëndetësia .....	24
<b>O5 PERCEPTIMET E INTEGRIMIT KONSTRUKTIV, TË SHPREHUR NË NUMRA .....</b>	<b>26</b>
5.1 Arsimi: Sistem që konsiderohet që çalon në cilësi dhe gjithëpërfshtirje .....	26
5.2 Shëndetësia: I disponueshëm, por jo i qëndrueshëm në cilësi.....	27
5.3 Trashëgimia Kulturore: Një shqetësim i përbashkët .....	28
5.4 Mundësitetë ekonomike: Një burim i madh i frustrimit .....	28
<b>O6 KONKLUSIONET .....</b>	<b>30</b>

# Përbledhje ekzekutive

Ky raport eksploroni sfidat dhe mundësitë për integrimin e komunitetit serb të Kosovës në sektorët kyç si arsimi, shëndetësia, trashëgimia kulturore dhe ekonomia. Gjetjet bazohen në të dhënat primare të mbledhura përmes dy diskutimeve në fokus grupe me komunitetin serb të Kosovës në Mitrovicën e Veriut në muajin gusht të vitit 2024 dhe me komunitetin shqiptar të Kosovës në muajin shtator të vitit 2024, krahas një analize të burimeve dytësore, duke përfshirë dokumentet ligjore, raportet dhe analizat e ekspertëve.

Analiza jonë tregon se integrimi kuptimplotë i serbëve të Kosovës është i lidhur ngushtë me normalizimin më të gjërë politik të marrëdhënieve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. Pa përparim të dukshëm në këtë fushë, përpjekjet për integrimin e serbëve të Kosovës me shumë gjasa do të përballen me rezistencë nga ky komunitet. Qasja e qeverisë së Kosovës ndaj komunitetit serb të Kosovës duhet të shkojë drejt një diskursi që promovon të drejtat ekzistuese të garantuara me Kushtetutën e Kosovës dhe planin e Ahtisarit.

Diskutimet tona në fokus grupe kanë nxjerrë në pah konfuzionet dhe keqkuptimet e konsiderueshme rreth asaj se çfarë përfshin integrimi i shkollave ku mësimi zhvillohet në gjuhën serbe ose sistemi shëndetësor i financuar nga Serbia në Kosovë. Në mesin e serbëve të Kosovës, ekziston shqetësimi se integrimi mund të nënkuptojë humbjen e kontrollit mbi vendimet, si për shembull se cilat tekste shkollore duhet të përdorin ose programet mësimore në shkollat e tyre. Ndërkohë, edhe komunitetit shqiptar të Kosovës duket se i mungon njouria apo mirëkuptimi i plotë për të drejtat e garantuara për serbët e Kosovës në fusha të tilla si arsimi dhe shëndetësia. Për shembull, Kushtetuta e Kosovës u jep serbëve të Kosovës të drejtën të përdorin tekstet shkollore serbe, të ndjekin plan programin serb, të marrin fonde nga qeveria serbe dhe të drejtën që komuna e Mitrovicës së Veriut mund të themelojë universitet. Këto keqkuptime nxjerrin në pah nevojën për komunikim më të qartë dhe shkëmbim informacioni për të kapërcyer hendekun midis komuniteteve.

Opioni i gjërë i Kosovës duhet të jetë më shumë i informuar për të drejtat dhe autonominë ekzistuese që gjëzon komuniteti serb sipas kornizës legjislative të Kosovës. Keqkuptimet rreth masës së këtyre të drejtave, si edhe e drejta e shkollave që mësimin e mbajnë në gjuhën serbe për të funksionuar sipas plan programeve serbe dhe për të marrë fonde nga Serbia, kanë kontribuar në perceptimet negative se masa të tilla janë koncesione dhe jo të drejta ligjore të garantuara.

Qeveria e Kosovës duhet të e ketë si prioritet dialogun e brendshëm të premtuar prej kohësh me komunitetin serb. Ky dialog duhet të zhvillohet në mënyrë transparente, me fokus në ndërtimin e besimit dhe adresimin e shqetësimeve të komunitetit. Masat e ndërtimit të besimit, në koordinim me aktorët ndërkombëtarë si BE, SHBA dhe vendet e QUINT-it, do të janë venditmare për nxitjen e një marrëdhënieje konstruktive.

Integrimi ekonomik është ende i kufizuar, ku komunat me shumicë serbe kryesisht mbështeten në punësimin e sektorit publik dhe ekonomitë joformale, përderisa përpjekjet për të formalizuar ekonominë dhe për të nxitur bashkëpunimin e biznesit ndëretnik janë përballur me rezistencë në veri të Kosovës, ndërsa në jug ka disa nivele të bashkëpunimit biznesor ndëretnik.

Janë disa çështje urgjente që pengojnë potencialin për integrim ekonomik dhe pengojnë zhvillimin e sektorit të biznesit në zonat me shumicë serbe, veçanërisht në veri të Kosovës. Në vend që të nxisin rritjen, këto sfida kontribuojnë në mbylljen ose reduktimin e ndjeshëm të aktivitetit të biznesit. Faktorët kryesorë përfshijnë situatën e brishtë politike dhe të sigurisë, veçanërisht në veri, ndalimin e pjesshëm të importit të mallrave serbe, hapjen e bizneseve shqiptare të motivuar politikisht në veri dhe fushatat e vazhdueshme për të dekurajuar blerjen e produkteve serbe. Përveç kësaj, prodhuesit serbë të Kosovës përballen me mundësi të kufizuara për të hyrë në tregjet më të gjera të Kosovës dhe Shqipërisë, gjë që e rëndon edhe më tej izolimin ekonomik. Kjo dinamikë jo vetëm që minon bizneset lokale, por gjithashtu thellon ndarjet etnike, duke penguar qëllimet më të gjera të integrimit rajonal dhe bashkëpunimit ekonomik.

Integrimi i shkollave në gjuhën serbe në sistemin arsimor të Kosovës është i stërmbrashur me ndjeshmëri politike dhe shqetësime të thella brenda komunitetit serb të Kosovës, si për shembull se si do të ndikojë në plan programin e shkollës nëse do të minonte identitetin dhe kulturën serbe, si dhe çështjen e vendeve të punës të mësimdhënësve rëndësishme të theksohet në këtë kontekst është se nen 12 i Ligjit Nr. O3/L-068 për Arsimin në Komuna thotë qartë se "Shkollat të cilat jepin mësim në gjuhën serbe mund të përdorin plan programe apo tekste shkollore të hartuara nga Ministria e Arsimit e Republikës së Serbisë pas njofimit të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë së Republikës së Kosovës."<sup>1</sup> Në nivelin e politikave, ekziston një shqetësim i vërtetë në mesin e komunitetit serb të Kosovës në lidhje me kornizën rregullatore arsimore të Kosovës në lidhje me raportin nxënës-mësues, i cili potencialisht mund të çojë në mbylljen e shumë shkollave, veçanërisht në fshatrat më të vogla të banuara me serbë. Kjo do të prekte në mënyrë disproporcionale komunitetet nga zonat rurale, ku nxënësit serbë të Kosovës tashmë janë më të izoluar, dhe mund të zgjedhë më tej praninë e serbëve të Kosovës në këto zona. Korniza ligjore e Kosovës garanton mbrojtjen e trashëgimisë kulturore serbe. Megjithatë, rastet e politizimit të çështjeve kulturore kanë nxitur mosbesim.

Raporti vjen në përfundim se ekzistojnë zgjidhje për të ecur drejt integrimit konstruktiv, por zbatimi do të jetë sfidues. Suksesi varet nga vullneti politik i Kosovës edhe i Serbisë për t'u angazhuar në dialog transparent, duke i shmangur retorikës nxitëse dhe për të siguruar mbështetje për masat integruese nga komuniteti serb i Kosovës përmes iniciativave për ndërtimin e besimit. Mbështetja dhe koordinimi ndërkombëtar me BE-në dhe SHBA-në do të jenë gjithashtu vendimtare për ecurinë e procesit.

---

<sup>1</sup> Shih Ligjin Nr. O3/L-068 <https://qzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2543>

# 01 Hyrje

Ky raport analizon sfidat dhe mundësitë për integrim konstruktiv të komunitetit serb të Kosovës në katër sektorët kyç: arsim, shëndetësi, trashëgimi kulturore dhe ekonomia. Për këtë raport, ne përdorim konceptin e integrimit konstruktiv për t'iu referuar një procesi që bazohet në pëlgimin, konsultimin dhe koordinimin dhe që nuk imponohet. Kjo do të thotë se është një proces që është i koordinuar dhe konsultuar ngushtë me BE-në, SHBA-në dhe, në përgjithësi, me vendet e QUINT-it, dhe, më e rëndësishmja, me komunitetin lokal serb në Kosovë. Për më tepër, kjo do të thotë se procesi është rezultat i dialogut të normalizimit. Kjo qasje siguron që masat e integrimit të mbështeten nga komuniteti dhe të mos imponohen. Qeveria e Kosovës duhet të ndërmarrë disa masa për ndërtimin e besimit në mënyrë që të ketë një mirëkuptim më të mirë dhe njëfarë besimi ndërmjet qeverisë dhe komunitetit serb të Kosovës dhe të sigurojë që integrimi të jetë gjithëpërfshirës dhe se i respekton drejtat dhe autonominë e parashikuar në Planin e Ahtisarit dhe Kushtetutën e Kosovës.

Integrimi efektiv i komunitetit serb të Kosovës është vendimtare për të tashmen dhe të ardhmen e Kosovës si shoqëri demokratike dhe multietnike, por megjithatë mbetet një sfidë e rëndësishme për shkak të barrierave politike, sociale dhe ekonomike. Edhe pse Plani i Ahtisarit dhe Kushtetuta e Kosovës ofrojnë një kornizë të fortë ligjore që garanton të drejtat dhe autonominë e komuniteteve joshumicë, veçanërisht të serbëve të Kosovës, zbatimi i këtyre dispozitave ka qenë i paqëndrueshëm dhe i penguar nga tensionet politike dhe mosbesimi. Këto sfida përkeqësohen edhe më shumë nga mosmarrëveshjet e pazgjidhura ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, si dhe nga përqarjet e brendshme brenda Kosovës. Rrjedhimisht, avancimi i integrimit do të kërkojë jo vetëm garanci ligjore, por edhe përpjekje aktive për të ndërtuar besim, për të nxitur dialogun dhe për të krijuar mundësi të prekshme për integrim.

Raporti është i organizuar në tre seksione kryesore. Seksioni i parë shqyrton gjendjen e përgjithshme në arsim, shëndetësi, ekonomi dhe trashëgimi kulturore në raport me serbët e Kosovës. Seksioni i dytë shqyrton më thellë sfidat për integrimin në secilin sektor, ndërsa pjesa e tretë diskuton mënyrën se si të ecim përpara përmes integrimit konstruktiv.

Metodologjia për këtë raport bazohet në një kombinim të burimeve parësore dhe dytësore. Të dhënat primare u mblodhën përmes dy diskutimeve në fokus grupe të mbajtura me pjesëtarët e komunitetit serb të Kosovës në Mitrovicën e Veriut në gusht 2024 dhe pjesëtarët e komunitetit shqiptar të Kosovës në Prishtinë në shtator 2024. Këto fokus grupe dhanë njohuri mbi perspektivat e komunitetit mbi çështjet kyçe, duke përfshirë arsimin, kujdesin shëndetësor, trashëgiminë kulturore dhe pjesëmarrjen ekonomike. Të dhënat cilësore nga këto diskutime ishin të rëndësishme në identifikimin e shqetësimeve, frikës dhe pritjeve të komunitetit serb të Kosovës lidhur me integrimin.

Përveç të dhënavë parësore, raporti mbështetet gjerësisht në burime dytësore, duke përfshirë dokumente ligjore, raporte nga organizatat ndërkombëtare si Komisioni Evropian dhe OSBE, dhe analiza akademike. Këto burime dytësore janë përdorur për të kontekstualizuar gjetjet nga fokus grupet dhe për të ofruar një pasqyrë më të thellë të kornizave ligjore dhe institucionale që rregullojnë integrimin e komuniteteve joshumicë në Kosovë. Raportet kryesore dhe dokumentet ligjore, si Plani i Ahtisarit, Kushtetuta e Kosovës

dhe marrëveshje të ndryshme të ndërmjetësuara nga BE-ja ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, u analizuan për të kuptuar sfidat strukturore dhe ligjore me të cilat përballen përpjekjet integruese.

Kjo qasje me metoda të përziera siguroi që raporti të pasqyronte përvojat e përjetuara të pjesëtarëve të komunitetit dhe kontekstin më të gjerë politik, ligjor dhe institucional në të cilin kanë ndodhur këto përvoja të përjetuara.

# 02 Shqyrtimi i gjendjes së tanishme në arsim, shëndetësi, trashëgimi kulturore dhe ekonomi

Gjendja aktuale e integrimit të komunitetit serb të Kosovës në arsim, shëndetësi, trashëgimi kulturore dhe ekonomi pasqyron sfida të rrënjosura thellë që mbeten të pazgjidhura. Përderisa korniza legjislative e Kosovës, kryesisht e bazuar në Planin e Ahtisarit, ofron të drejta dhe autonomi të gjerë për komunitetet joshumicë, duke përfshirë popullatën serbe të Kosovës, zbatimi praktik ka qenë i kufizuar. Secil fushë përballet me sfida unike dhe pavarësisht përpjekjeve për pajtim dhe integrim, mosbesimi, tensionet politike dhe joefikasiteti sistematik vazhdojnë të pengojnë progresin. Ky seksion ofron një analizë të detajuar të gjendjes aktuale në këta sektorë kritikë, duke theksuar boshllëqet dhe mundësitë për nxitjen e përfshirjes më të madhe.

## 2.1 Education

Gjendja e arsimit mbetet shqetësimi themelor për komunitetin serb në Kosovë, kryesisht për shkak të lidhjeve të tij simbolike dhe praktike me Serbinë, si dhe për shkak të rëndësise së tij jetike për komunitetin serb të Kosovës. Përkundër synimit për krijimin e një sistemi të integruar arsimor si pjesë e përpjekjeve për ndërtimin e paqes pas konfliktit, sistemi arsimor i Kosovës mbetet i ndarë sipas vijave etnike. Shkollat që mbajnë mësimin në gjuhën serbe funksionojnë brenda sistemit arsimor serb, duke përdorur plan programet serbe dhe duke iu përmbytjut rregullave serbe. Besimi është çështja kryesore për integrim, siç edhe deklaroi një serb i Kosovës, ‘Në fund të fundit mund të e pranoj integrimin, por nuk mund t'i dërgoj fëmijët e mi në një shkollë shqipe apo mjek shqiptar.’<sup>2</sup> Kjo pasqyron mosbesimin e thellë ndaj institucioneve të Kosovës.

Korniza ligjore, megjithatë, ofron autonomi të konsiderueshme për shkollat që mbajnë mësim në gjuhën serbe. Kushtetuta e Kosovës u garanton komuniteteve joshumicë të drejtën për t'u arsimuar në gjuhën e tyre dhe për të themeluar institucion private arsimore. Neni<sup>59</sup> i Kushtetutës shpreh se pjesëtarët e komuniteteve joshumicë kanë të drejtë të “të marrin arsimim publik në të gjitha nivelet, në njëren nga gjuhët zyrtare të Republikës se Kosovës, sipas zgjidhjes së tyre” dhe të themelojnë institucionet e tyre arsimore. Megjithatë, një pengesë kryesore për integrimin mbetet mungesa e besimit në institucionet e Kosovës, veçanërisht në veri të Kosovës, ku 70% e serbëve të Kosovës raportojnë se nuk kanë besim në qeverinë e Kosovës. Siç u cek gjatë diskutimit në fokus grup me pjesëtarët e komunitetit serb të Kosovës, mosbesimi është i drejtuar kryesisht ndaj procesit ende të padefinuar të integrimit dhe sfidave të ndryshme që mund të shfaqen gjatë këtij tranzicioni. Nga këndvështrimi i komunitetit serb në Kosovë, Asociacioni/Bashkësia e ardhshme e Komunave me shumicë serbe në Kosovë

2 Një i ri serb i Kosovës i cituar në raportin “Integrimi serb në Kosovë pas marrëveshjes së Brukselit” shkruar nga Marko Prelec dhe Naim Rashiti për Grupin për Hulumtimin e Politikave në Ballkan (BPRG), f. 40, në dispozicion në: <https://balkansgroup.org/wp-content/uploads/2019/11/Serb-Integration-in-Kosovo-After-Brussels-Agreement-2.pdf>

duhet të marrë përgjegjësinë për mbikëqyrjen e shkollave në gjuhën serbe në Kosovë, dhe në përgjithësi, themelimi i AKS shihet si elementi kyç për integrimin konstruktiv të komunitetit serb në Kosovë.

Mospërputhjet në të dhënat e regjistrimit të studentëve ndërlikojnë më tej përpjekjet për integrim. Përderisa zyrtarët serbë raportojnë<sup>22, 546</sup> nxënës në<sup>132</sup> shkolla në gjuhën serbe, Ministria e Arsimit e Kosovës nuk i ka përditësuar të dhënat për këto shkolla që nga viti<sup>2015</sup>. Pjesëmarrësit në fokus grupe nga komuniteti serb në veri të Kosovës vunë në dukje se largimi po shihet gjithnjë e më shumë si zgjëdhje për shkak të situatës sfiduese politike dhe të sigurisë, sepse situata sfiduese politike dhe e sigurisë në veri në vitet e fundit është bërë një nga faktorët shtytës. Kjo situatë ka sjellë edhe rënie të numrit të studentëve serbë të Kosovës dhe ulje të ardhjes së studentëve nga Serbia dhe Mali i Zi.

Mungesa e koordinimit ndërmjet autoritetetve arsimore të Kosovës dhe Serbisë e fragmenton edhe më tej sistemin arsimor dhe qeveria e Kosovës bënë përpjekje për të siguruar financim të barabartë për shkak të këtyre mospërputhjeve. Pavarësisht kësaj, Kosova vazhdon të ndajë mjete për shkollat me mësim në gjuhën serbe nga buxheti i saj publik, edhe pse mbi<sup>80%</sup> e buxhetit të arsimit shpenzohet për pagat e mësuesve, duke lënë shuma të pakta për investime në përmirësimin e cilësisë së arsimit. Komisioni Evropian e ka kritikuar këtë qasje në raportet e tyre vjetore për Kosovën.<sup>3</sup>

In this context, a particular concern is the salary discrepancy between teachers in the Kosovo and Serbian systems, which may serve as a major disincentive for teachers in Serbian-speaking schools in Kosovo to support integration efforts. Establishing the Association/Community of Serb-majority Municipalities could play an important role in addressing this issue by creating a potential salary top-up system as a transitional solution for teachers in these schools.

Një diskutim në fokus grup me shqiptarët e Kosovës tregon se ata e perceptojnë sektorin e arsimit në Kosovë si shumë të segreguar, me shkollat në gjuhën serbe që funksionojnë të pavarura nga sistemi arsimor i Kosovës, duke vënë në dukje se ky perceptim i një sistemi arsimor të segreguar në Kosovë ndihmon në nxitjen e ndarjes në shoqër.<sup>4</sup>

Megjithatë, ajo që është e rëndësishme të theksohet është se sa pak e dinin të gjithë pjesëmarrësit se si funksionojnë shkollat që mësimin e mbajnë në gjuhën serbe në Kosovë dhe cilat janë të drejtat në sektorin e arsimit të garantuara me legjislacionin e Kosovës për serbët e Kosovës. Për shembull, pjesëmarrësit u befasuan që shkollatqë mësimin e mbajnë në gjuhën serbe në Kosovë u lejohet të përdorin plan programet e tyre dhe se komuna e Mitrovicës së Veriut ka të drejtë ligjore për të themeluar universitet.

---

<sup>3</sup> Shih për shembull, Raportin e Kosovës\* 2024 [https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/document/download/c790738e-4cf6-4a43-a8a9-43c1b6f01e10\\_en?filename=Kosovo%20Report%202024.pdf](https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/document/download/c790738e-4cf6-4a43-a8a9-43c1b6f01e10_en?filename=Kosovo%20Report%202024.pdf)

<sup>4</sup> Diskutim në fokus-grup me komunitetin shqiptar të Kosovës. Prishtinë, 12 shtator 2024

## 2.2 Shëndetësia

Ashtu si arsimi, edhe sektori i shëndetësia në Kosovë është i segreguar, me komunat me shumicë serbe që mbështeten në një sistem paralel të kujdesit shëndetësor të financuar dhe menaxhuar nga Serbia. Kjo ndarje shihet si qenësore nga komuniteti serb i Kosovës, jo vetëm për mbajtjen e lidhjeve me Serbinë, por edhe për shkak të perceptimit se cilësia e shërbimeve shëndetësore serbe është dukshëm më e mirë kundrejt sistemit shëndetësor publik me financim të pamjaftueshëm të Kosovës. Gjatë periudhës së Pandemisë COVID-19, qeveria serbe ofroi vaksina dhe mbështetje tjetër mjekësore drejtpërdrejt për zonat me shumicë serbe pa koordinim me autoritetet e Kosovës, duke përforcuar më shumë pavarësinë e sistemit paralel të kujdesit shëndetësor.

Megjithatë, ekziston një fushë e rrallë e bashkëpunimit ndëretnik në sektorin privat të kujdesit shëndetësor, ku mjekët shqiptarë dhe serbë të Kosovës shpesh punojnë së bashku në klinika dhe spitale private. Pacientët nga të dy komunitetet janë gjithashtu të gatshëm të kërkojnë trajtim nga mjekët e përkatësisë tjetër etnike, duke treguar se kujdesi shëndetësor, ndryshe nga arsimi, është më pak i ngarkuar politikisht në nivel individual. Një shembull nga Prishtina Insight e ilustron këtë: “Pesëdhjetë e gjashtë vjeçari Ismet L. nuk e kishte imagjinuar kurrë vetën që do t'i nënshtrohej një operacioni në spitalin e Mitrovicës së Veriut. ... Të nesërmen Ismeti shkoi në spital, dhe pas kryerjes së analizave iu nënshtrua operacionit.” Shembuj të tillë të ndërveprimeve të kujdesit shëndetësor ndërmjet komuniteteve janë inkurajues, megjithëse ato mbeten të kufizuara vetëm në sektorin privat.

Pavarësisht autonomisë që u është dhënë komunave me shumicë serbe në kujdesin shëndetësor, duke përfshirë të drejtën për të menaxhuar kujdesin sekondar shëndetësor dhe për të regjistruar institucionet shëndetësore, shumë komuna, si Mitrovica Veriore, ende nuk kanë themeluar departamente komunale të shëndetësisë. Për më tepër, Ministria e Shëndetësisë e Kosovës nuk ka të dhëna për institucionet e kujdesit shëndetësor në zonat me shumicë serbe, gjë që kufizon mundësinë e qeverisë për të mbikëqyrur dhe përmirësuar integrimin e kujdesit shëndetësor. Dialogu i ndërmjetësuar nga BE-ja ka bërë pak përparim në çështjet e kujdesit shëndetësor, përveç marrëveshjes së vitit 2015 për njohjen reciproke të Certifikatave të Produktave Medicinale (CPP), e cila ende nuk zbatohet mjaftueshëm.

## 2.3 Trashëgimia kulturore

Mbrojtja e trashëgimisë kulturore dhe fetare është e përfshirë në Kushtetutën dhe kornizën legjislativë të Kosovës, me të drejta të mëdha të bazuara në Planin e Ahtisarit. Plani i njeh në mënyrë eksplikite objektet fetare të Kishës Ortodokse Serbe në Kosovë (KOS), siç janë manastiret dhe kishat, si pjesë përbërëse të trashëgimisë serbe në Kosovë, dhe Kosova është e obliguar t'i mbrojë këto objekte. Aneksi V i Planit të Ahtisarit përcakton se Kosova duhet “të njohë Kishën Ortodokse Serbe në Kosovë... si pjesë integrale e Kishës Ortodokse Serbe me seli në Beograd.”

Megjithatë, zbatimi i këtyre ligjeve ka qenë jokonsistent. Shembulli më domethënës ishte

moszbatimi i vendimit të Gjykatës Kushtetuese të vitit 2016 që konfirmonte pronësinë e tokës përreth Manastirit të Deçanit. Kjo ka çuar në kritika të gjera nga akterët ndërkombëtarë, përfshirë Europa Nostra, e cila e përfshiu manastirin në listën e shtatë vendeve më të rezikuara të trashëgimisë kulturore në Evropë. Siç theksoi organizata, “Vetë fakti që një monument i kulturës evropiane duhet të mbrohet vazhdimesht nga një forcë ushtarake është një tregues se Kosovës i duhet ende më shumë për të bërë për të krijuar [një] shoqëri multikulturore.” Megjithatë, në mars 2024, Vendimi i Gjykatës Kushtetuese të Kosovës i vitit 2016, i cili i dha 24 hektarë tokë Manastirit Ortodoks Serb të Deçanit, u zbatua zyrtarisht dhe se toka u regjistrua si pronë e manastirit në Kadastrën Qendrore të Kosovës. Zgjidhja e kësaj çështje erdhi për shkak se Këshilli i Evropës (KE) e bëri kusht për avancimin e kërkesës për anëtarësim të Kosovës në KiE.

Përderisa legjislacioni i Kosovës ofron të drejta të gjera për KOS-in, perceptimi i kishës si një aktor politik dhe jo si një institucion fetar i ndërlidon përpjekjet për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore. Përmirësimi i marrëdhënieve ndërmjet qeverisë së Kosovës dhe KOS-it, dhe sigurimi që vendet e trashëgimisë kulturore të depolitizohen, është thelbësor për nxitjen e bashkëpunimit më të madh.

## 2.4 Ekonomia

Raportet ekonomike ndërmjet shqiptarëve dhe serbëve në Kosovë janë të dobëta, kryesisht për shkak të vazhdimësisë së ekonomisë në hije në zonat me shumicë serbe dhe se komunitetit serb në Kosovë kryesisht mbështetet në punësimi në sektorin publik. Bizneset serbe në Kosovë, veçanërisht në komunat veriore, operojnë brenda rrjeteve joformale që i rezistojnë integrimit në kornizën ekonomike të Kosovës. Përpjekjet e qeverisë së Kosovës për të luftuar krimin e organizuar dhe ekonominë joformale në këto zona janë përballur me rezistencë, e cila shpesh shihet nga serbët lokalë si përpjekje për të minuar autonominë e tyre.

Përkundër sfidave, sektori privat ofron disa shembuj të bashkëpunimit ndëretnik. Në veçanti, sektori privat i kujdesit shëndetësor dhe sipërmarrjet e vogla biznesore në komunat e decentralizuara si Graçanica/Graçanica dhe Shterpce/Štrpcë kanë pasur sukses modest. Megjithatë, këta shembuj janë të rrallë dhe ka pasur investime të kufizuara në iniciativat e përbashkëta të biznesit në mes të komunitetit shqiptar dhe serb të Kosovës. Siç vërehet nga një ekspert, “Shumë pak është bërë në forcimin e përfshirjes së ndërmarrjeve në pronësi të komuniteteve të ndryshme etnike.”

Strategjisë së përgjithshme ekonomike të Kosovës i mungon një fokus specifik për komunitetet joshumicë. As Strategjia Kombëtare e Zhvillimit 2016-2021 dhe as Strategjia Kombëtare për Zhvillim- 2030 nuk përfshijnë masa të synuara për komunat me shumicë serbe. Fondi i Zhvillimit për veriun e Kosovës, i themeluar përmes dialogut të lehtësuar nga BE-ja, ka bërë disa përparime në promovimin e zhvillimit socio-ekonomik në komunat veriore, por ndikimi i tij mbetet i ko mjaft i përfaqësuar në mediat e Kosovës. Është e rëndësishme të theksohet se së fundi, heqja e masës së ndalimit të importit të produkteve nga Serbia ka rezultuar në zbatimin e pjesshëm të kësaj ndalese, pasi mallrat nga Serbia po hyjnë në Kosovë kryesisht përmes pikëkalimit Merdare, duke anashkaluar pikat kufitare Jarinjë /Jarinje dhe Bërnjak/Brnjak në veri. Kjo ndryshim ka pasur ndikim të drejtpërdrejtë

në Fondin Zhvillimor për Veriun e Kosovës, i cili mbledh të hyra nga këto pika kufitare veriore, duke ulur kështu të ardhurat e tij potenciale dhe duke e komplikuar më tej situatën ekonomike të rajonit. Shkëmbimi tregtar ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, e vlerësuar në 344 milionë euro në vitin 2022, ra ndjeshëm pasi Kosova vendosi ndalimin e importit të mallrave serbe në vitin 2023, duke acaruar më tej marrëdhëniet ekonomike. Rregullorja e Bankës Qendrore të Kosovës për operacionet me para të gatshme nga fundi i vitit 2023 ka tensionuar më tej bizneset në zonat me shumicë serbe. Shfuqizimi i sistemit serb të pagesave do të thotë që qytetarët e punësuar në institucionet serbe në Kosovë mund të tërheqin pagat vetëm në Serbi, ku qëndron një pjesë e konsiderueshme e parave të tyre.

Pavarësisht kornizës së avancuar ligjore të ofruar nga Plani i Ahtisarit, zbatimi praktik mbetet i kufizuar për shkak të tensioneve politike, mosbesimit dhe joefikositetit sistematik. Sistemet e arsimt dhe ai shëndetësor janë ende kryesisht të ndara, me shumë pak koordinim ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. Përderisa mbrojtja e trashëgimisë kulturore është e sankzionuar në ligjet e Kosovës, politizimi i këtyre çështjeve ndërlikon përpjekjet për të mbrojtur sitet ortodokse serbe. Ekonomikisht, vazhdimësia e ekonomisë gri dhe mungesa e iniciativave të përbashkëta të biznesit pengojnë bashkëpunimin kuptimplotë. Për të ecur përpara, si qeveria e Kosovës ashtu edhe komuniteti serb i Kosovës duhet të angazhohen në dialog dhe bashkëpunim, me mbështetjen e aktorëve ndërkombëtarë, për të kapërcyer këto sfida dhe për të nxitur një integrim më të madh.

# 03 Një vështrim më i afërt mbi sfidat për integrimin konstruktiv në arsim, shëndetësi, trashëgimi kulturore dhe ekonomi

Integrimi i komunitetit serb të Kosovës në sistemet e Kosovës në sektorët e arsimit, shëndetësisë, trashëgimisë kulturore dhe ekonomisë mbetet një sfidë e rëndësishme. Pavarësisht kornizës legislative të ofruar nga Plani i Ahtisarit dhe Kushtetuta e Kosovës, pengesat praktike vazhdojnë, shpesh të përkeqësuara nga tensionet politike dhe mosbesimi. Ky seksion eksploron sfidat kryesore në këta sektorë, duke ofruar një vështrim më të afërt të barrierave strukturore dhe duke theksuar mundësitë për progres bazuar në marrëveshjet ekzistuese dhe kornizat ligjore. Adresimi i këtyre sfidave do të kërkojë përpjekje të koordinuara nga qeveria e Kosovës, serbët e Kosovës dhe palët e interesuara ndërkombëtare..

## 3.1 Arsimi

Sistemi arsimor në Kosovë mbetet shumë i segreguar, me shkollat në gjuhën serbe që funksionojnë sipas plan programit serb dhe financohen nga Serbia. Përderisa kjo marrëveshje mbështetet nga Plani i Ahtisarit, i cili thotë se “shkollat që jepin mësim në gjuhën serbe mund të aplikojnë kurrikulë apo tekste mësimore të përgatitura nga Ministria e Arsimit e Republikës së Serbisë pas njoftimit në Ministrinë e Arsimit të Kosovës”, mungesa e Komunikimi ndërmjet shkollave serbe dhe Ministrisë së Arsimit të Kosovës përbën një sfidë të madhe. Sipas zyrtarëve të lartë të qeverisë së Kosovës, “nuk ka pasur asnjë përpjekje nga shkollat që mbajnë mësimin në gjuhën serbe për të informuar ministrinë për kurrikulat e tyre”, gjë që çoi në mungesë të mbikëqyrjes dhe transparencës në sistem.

Për më tepër, përafrimi i kurrikulës së përdorur nga shkollat që mësimin e mbajnë në gjuhën serbe në Kosovë, mund të rezultojë të jetë një detyrë e vështirë, veçanërisht për lëndët si historia, për shkak të narrativave të ndryshme dhe konkurruese për të kaluarën midis shqiptarëve të Kosovës dhe serbëve të Kosovës.<sup>5</sup> Ky shqetësim u theksua edhe gjatë fokus grupit me pjesëtarët e komunitetit serb të Kosovës.

Sfidë tjetër kyçë është njohja e diplomave nga institucionet serbe, veçanërisht nga Universiteti i Mitrovicës së Veriut. Përderisa Kosova njuhi 96 për qind të kërkesave për njohje të diplomës, Vendimi i Gjykatës Kushtetuese të Serbisë i vitit 2014, e cila e shpalli Marrëveshjen e vitit 2011 për pranimin e ndërsjellë të diplomave universitare nuk është në pajtim me ligjin serb, vazhdon të krijojë bariera për të diplomuarit serbë të Kosovës

<sup>5</sup> Ardit Orana dhe Ramadan Ilazi, "Dialogu Kosovë-Serbi: Pasojat e status-quo-së", Mars, 2022, QKSS dhe NSI, [https://qkss.org/images/uploads/files/Status-Quo\\_Report.pdf](https://qkss.org/images/uploads/files/Status-Quo_Report.pdf)

që kërkojnë punësim sektorit publik të Kosovës. Kjo ka bërë që shumë studentë të cilët kanë studiuar në gjuhën serbe të mos jenë në gjendje t'i shfrytëzojnë diplomat e tyre pér punësim në Kosovë përkundër marrëveshjeve ekzistuese. Siç vuri në dukje një zyrtar kosovar, "Përpjekjet pér të angazhuar një profesor pér të zhvilluar ligjërata në Universitetin e Prishtinës dështuan sepse institucioni serb nuk iu përgjigj asnjëherë kërkesave të përsëritura pér të verifikuar diplomën."

Një shqetësim i madh në mesin e komunitetit serb të Kosovës është mundësia e integrimit të detyruar të shkollave të tyre në sistemin arsimor të Kosovës. Gjatë një fokus grupei në gusht 2024, pjesëmarrësit shprehën frikën se integrimi do të conte në mbylljen e shkollave në gjuhën serbe ose humbjen e vendeve të punës pér profesorët serbë të Kosovës, shumë prej të cilëve janë të punësuar përmes procedurave të ndryshme nga ato që përdoren në Kosovë. Plani i Ahtisarit siguron mbrojtje pér shkollat në gjuhën serbe, por ndalimi i vazhdueshëm i teksteve shkollore serbe në Kosovë që nga viti 2015 ka tensionuar marrëdhëniet dhe ka shtuar perceptimin e asimilimit të detyruar.

Mungesa e Asociacionit/Bashkësisë së Komunave me Shumicë Serbe (AKS) në Kosovë pengon pérparimin në integrimin e shkollave në gjuhën serbe në sistemin arsimor të Kosovës. Ky mekanizëm mund të ndihmojë në koordinimin e sfidave logjistike dhe administrative që lidhen me procesin e integrimit. Krijimi i AKS mund të përmirësojë komunikimin dhe të zbusë shqetësimet mes serbëve të Kosovës në lidhje me integrimin e shkollave në gjuhën serbe në sistemin arsimor të Kosovës.

Diskutimi i fokus grupeve me të rinxjtë dhe studentët e komunitetit shqiptar të Kosovës tregon se ata ndjejnë fuqimisht se ka cilësi të dobët në sektorin e arsimit në Kosovë, veçanërisht në shkollat filllore. Pjesëmarrësit në fokus grup vunë në dukje dështimin e reformave dhe theksuan se shkollat nuk fokusohen në zhvillimin e të menduarit kritik, por në të mësuarit përmendësh. Pjesëmarrësit besuan se kjo çështje prek të gjitha komunitetet dhe mund të shërbejë si pikënisje pér përpjekjet e përbashkëta pér reforma.

Diskutimi i fokus-grupit me komunitetin shqiptar të Kosovës në mënyrë të përsëritur theksoi rëndësinë e mësimit të gjuhës shqipe dhe serbe në shkollat e Kosovës. Megjithatë, pjesëmarrësit shprehën preferencë që lënda e gjuhës të mbete zgjedhor dhe jo si lëndë të detyrueshme. Ky është potencialisht një tregues i ndjeshmërisë së vazhdueshme të disa shqiptarëve të Kosovës ndaj mësimit të gjuhës serbe si lëndë e detyrueshme. Në një kontekst më të gjerë, është tregues i mungesës së një procesi ballafaqimi me të shkuarën.

Pjesëmarrësit e grupeve të fokusit shprehën gjithashtu zhgënjimin pér atë që ata e shohin si politizimin e librave shkollorë, veçanërisht të librave të historisë. Pjesëmarrësit e diskutimit në fokus grup me komunitetin shqiptar të Kosovës besojnë se në shkollat ku mësimi mbahet në gjuhën serbe, librat e historisë nuk e portretizojnë me saktësi luftën e viteve 1990. Ata besojnë se harmonizimi i teksteve shkollore, me të dhëna të ofruara nga të dy komunitetet dhe me theks në edukimin faktik dhe të paanshëm, është çelësi pér mirëkuptim më të madh të ndërsjellë.

## 3.2 Shëndetësia

Sektori i kujdesit shëndetësor paraqet sfida të ngjashme, veçanërisht sa i përket cilësisë dhe besimit në sistemin e kujdesit shëndetësor publik të Kosovës. Serbët e Kosovës kryesisht mbështeten në sistemin e kujdesit shëndetësor të Serbisë, i cili shpesh shihet si superior ndaj shërbimeve shëndetësore publike të Kosovës të financuar dobët dhe joefektive Një ekspert i kujdesit shëndetësor vuri në dukje, "Në Kosovë, është e pashmangshme të mos hasësh qytetarë që kërkojnë ndihmë financiare për trajtim jashtë vendit", duke nën vizuar mangësitë në sistemin e Kosovës. Kjo mbështetje në sistemin e kujdesit shëndetësor të Serbisë komplikohet edhe më shumë nga mungesa e një sistemi publik të sigurimit shëndetësor në Kosovë, të cilin e ka Serbia dhe nga i cili përfitojnë serbët e Kosovës. Vlen të përmendet se qasja në sistemin e kujdesit shëndetësor serb jo vetëm që ofron trajtim mjekësor brenda Serbisë, por shtrihet edhe në republikat e tjera të ish-Jugosllavisë, si Mali i Zi dhe Bosnja e Hercegovina, duke siguruar mundësi më të gjera të kujdesit shëndetësor për komunitetin serb të Kosovës në Kosovë.

Deficiti i besimit ndërmjet serbëve të Kosovës dhe institucioneve publike shëndetësore të Kosovës paraqet një pengesë të madhe për integrim. Sipas Barometrit të Sigurisë së Kosovës, 39% e serbëve të Kosovës kanë pak ose aspak besim në institucionet shëndetësore në Kosovë. Barrierat gjuhësore gjithashtu e thellojnë këtë mosbesim, ku shumë serbë të Kosovës raportojnë vështirësi në qasjen e shërbimeve shëndetësore në gjuhën e tyre amtare, pavarësisht se serbishtja është gjuha zyrtare në Kosovë. Në fokus grupin e gushtit 2024, pjesëmarrësit shprehën zhgënjin përvonesat në licencimin e barnave dhe regjistrimin e barnatoreve në komunat me shumicë serbe, gjë që e ka dobësuar më tej besimin në sistemin e Kosovës.

Integrimi në shëndetësi do të kërkojë që qeveria e Kosovës t'i adresojë këto shqetësimë drejtpërdrejt. Nevojitet të adresohet mesazh i qartë për të siguruar komunitetin serb të Kosovës se integrimi nuk do të thotë humbje e qasjes në privilegjet dhe shërbimet që ata gjëzojnë aktualisht nga sistemi shëndetësor i Serbisë. Ndërsa sistemi i kujdesit shëndetësor i Kosovës vazhdon të përmirësohet, duhet të bëhen përpjekje për të siguruar aksesin në gjuhë dhe për të rindërtuar besimin përmes rritjes së bashkëpunimit ndërmjet institacioneve të kujdesit shëndetësor në Kosovë dhe Serbi.

Ngjashëm me arsimin, edhe sistemi i kujdesit shëndetësor është i segreguar, me zonat me shumicë serbe që mbështeten në një sistem të kujdesit shëndetësor të financuar dhe menaxhuar nga Serbia. Diskutimi i fokus grupeve me komunitetin shqiptar të Kosovës tregon se ata besojnë se shërbimet e kujdesit shëndetësor do të ishin në dispozicion të tyre nëse nevojiten në komunat me shumicë serbe, megjithatë ende ka të folura në mesin e tyre për përdorimin e shërbimeve shëndetësore në komunat me shumicë serbe, dhe shumica e pjesëmarrësve e kanë si opsjon për të i përdorur ato vetëm në raste urgjente. Është edhe faktori gjuhësor, e që pjesëmarrësit e fokus grüpuit nuk besojnë se do të ketë punonjës shëndetësorë që flasin shqip. Shqetësimë të ngjashme janë të pranishme edhe te serbët e Kosovës. Në këtë kuptim, mosbesimi në shërbimet e kujdesit shëndetësor përtet linjave etnike është një pengesë kryesore për integrimin. Ekziston nevoja për përpjekje të koordinuara për disa masa për ndërtimin e besimit në sektorin e kujdesit shëndetësor, potencialisht përmes iniciativave shëndetësore ndërmjet komuniteteve dhe informacionit më të aksesueshëm në të dyja gjuhët zyrtare në Kosovë, shqip dhe serbisht.

Sistemi shëndetësor i udhëhequr nga Serbia në Kosovë po ashtu përballet me sfida të jashtme. Siç vunë re qytetarët gjatë diskutimit në fokus grup, procesi i licencimit për barnat e importuara nga Serbia mbetet i penguar nga kapaciteti i kufizuar i agjencisë kosovare, duke shkaktuar vonesa deri në një muaj në miratimin e barnave të destinuara për sistemin serb, duke krijuar vështirësi të konsiderueshme për institucionet shëndetësore dhe pacientët e tyre. Gjithashtu, pjesëmarrësit vunë re pengesa të rëndësishme në regjistrimin e barnatoreve dhe ambulantave mjekësore në institucionet e Kosovës, veçanërisht sfidat me njohjen e diplomave nga institucionet përkatëse, e cila është thelbësore si për themelimin ashtu edhe për funksionimin e këtyre ekonomive.

Pjesëmarrësit e diskutimit në fokus-grup me komunitetin shqiptar të Kosovës gjithashtu vunë në dukje problemet e rëndësishme të infrastrukturës dhe korruptionin brenda sistemit të kujdesit shëndetësor, të cilat prekin të gjitha komunitetet. Ndonëse shpesh konsiderohet si më i mirë se sa sistemi i Kosovës për sa i përket ofrimit të shërbimeve, sistemi shëndetësor i administruar nga Serbia në Kosovë përballet me shumë nga të njëjtat sfida, duke përfshirë korruptionin, nepotizmin, infrastrukturën e papërshtatshme dhe mungesën e fuqisë punëtore.

### 3.3 Trashëgimia Kulturore

Kosova ka një kornizë të fortë legislative për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore dhe fetare, veçanërisht kur bëhet fjalë për Kishën Ortodokse Serbe (KOS). Megjithatë, këto ligje janë zbatuar në mënyrë jokonsistente.

Trashëgimia kulturore dhe fetare serbe në Kosovë shpesh përballet me sulme institucionale dhe individuale. Gjatë diskutimit në fokus grup me pjesëtarët e komunitetit serb të Kosovës, qytetarët shprehën shqetësimë serioze lidhur me mungesën e konsiderueshme të respektit për trashëgiminë kulturore dhe fetare serbe. Trashëgimia dhe vendet fetare të Kishës Ortodokse Serbe (KOS) gëzojnë mbrojtje të zgjeruar nën Zonat e Veçanta të Mbrojtura (Z M). Megjithatë, zhvillimi i pakontrolluar përbën një kërcënim për integritetin e këtyre zonave.<sup>6</sup> Për shembull, një pjesë e rrugës së planifikuar Deçan—Plav (Mali i Zi) pritet të kalojë përmes zonës së veçantë mbrojtëse rrëth Manastirit të Deçanit. Kjo zonë, e përcaktaur sipas ligjit të Kosovës për të mbrojtur vendet e trashëgimisë kulturore, veçanërisht ato të lidhura me Kishën Ortodokse Serbe, ndalon projektet e infrastrukturës në shkallë të gjërë si rrugët, pasi ato përbëjnë një kërcënim për integritetin, qetësinë dhe mqedisin natyror të vendit. Kjo çështje mbetet e pazgjidhur dhe ndërkohë, plani i ri zhvillimor i bashkisë parashikon disa aktivitete të tjera të projektit brenda zonës së veçantë mbrojtëse të Manastirit.

Diskutimet e fokus grupeve me komunitetin serb të Kosovës theksuan disa shqetësimë në lidhje me trashëgiminë kulturore dhe fetare, të perceptuara si frikë nga përvetësimi kulturor. Për shembull, në nëntor 2023, ata përmendën një përpjekje për të marrë kontrollin e Kishës Ortodokse Serbe në fshatin Rakinicë/Rakinica afër Podujevës/Podujevo. Në mënyrë të ngjashme, Kisha e Burimit Jetëdhënës në Vinarc të Epërm/Gornje Vinarce, afër Mitrovicës së Veriut, raportohet se është riklasifikuar si kishë katolike romake nga Ministria e Kulturës e

<sup>6</sup> Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE), “Mbrojtja e Trashëgimisë Kulturore në Kosovë” 18 korrik 2022, <https://www.osce.org/mission-in-kosovo/522892>

Kosovës. Çështja më e fundit e ngritur lidhej me mbetjet e Manastirit Bogorodica Hvostanska (Virgjëreshës së Shenjtë të Hvosnos), një objekt i konsideruar historikisht i rëndësishëm nga Kisha Ortodokse Serbe dhe i lidhur me dioqezën e lashtë Hvosno, themeluar në 1219. Gjithashtu, igumeni i Manastirit të Devina Voda u dëbua nga Kosova në fund të tetorit 2023, pavarësisht se kishte një leje qëndrimi të vlefshme, të cilën e kishte rinouar pa vështirësi në vitet e kaluara. Edhe pse nuk është shtetas i Kosovës, igumeni u informua në Prishtinë se duhej të largohej nga vendi dhe se nuk i lejohet hyrja për pesë vjet për shkak të arsyeve të sigurisë kombëtare. Pjesëtarët e komunitetit shprehën shqetësim për procesin, duke vënë në dukje praninë e përfaqësuesve të OSBE-së dhe EULEX-it, gjë që i bëri ata të vënë në dyshim drejtësinë e procedurës. Ata cituan gjithashtu Ligjin për Lirinë Fetare në Kosovë, i cili ndalon ndalimet arbitrale të hyrjes për figurat fetare. Për më tepër, ka pasur disa incidente të raportuara që përfshinin përdhosjen e kishave dhe varrezave ortodokse serbe në mbarë Kosovën.<sup>7</sup> Këto dukuri shiheshin si burim shqetësimi dhe brenge nga komuniteti.

Politizimi i çështjeve të trashëgimisë kulturore në Kosovë i ka komplikuar edhe më shumë gjërat. Për shumicën shqiptarëve të Kosovës, Kisha Ortodokse Serbe shihet si një aktor politik dhe jo si një institucion fetar, për shkak të rolit të saj historik në mbështetjen e nacionalizmit serb gjatë viteve 1990. Ky perceptim është përforcuar nga kundërshtimi i KOS-it ndaj kërkesës së Kosovës për anëtarësim në UNESCO. Si rezultat, shumica e komunitetit shqiptar mbetet skeptikë ndaj synimeve të KOS-it dhe diskutimet për trashëgiminë kulturore shpesh shihen si “koncesione” ndaj Serbisë.

KOS-i mbetet një institucion jetik për komunitetin serb në Kosovë, dhe përmirësimi i marrëdhënieve ndërmjet qeverisë së Kosovës dhe KOS-it është thelbësor për mbrojtjen e objekteve kulturore serbe. Këshilli Zbatues dhe Monitorues (KPM), i themeluar me Ligjin për Zonat e Veçanta të Mbrojtura, mund të luajë një rol vendimtar në lehtësimin e këtij dialogu, por ai nuk është shfrytëzuar plotësisht. Ndërtimi i besimit do të kërkojë përpjekje të vazhdueshme nga të dyja palët, duke përfshirë masat e ndërtimit të besimit, siç është kontakti nga KOS me komunitetin shqiptar dhe pjesëmarrje më e madhe e liderëve të Kosovës në ngjarjet e KOS-it.

Pjesëmarrësit e diskutimit në fokus-grup të komunitetit shqiptar të Kosovës shprehën nevojën për të prezantuar trashëgiminë e larmishme kulturore të Kosovës si një mjet për promovimin e marrëdhënieve më të mira ndëretnike. Ata sugjeruan promovimin e vizitave kulturore dhe shkëmbimeve mes nxënësve të shkollave të mesme për të kupuar më mirë trashëgiminë e njëri-tjetrit. Pjesëmarrësit e diskutimit në fokus-grup me shqiptarët e Kosovës ndanë perceptimet e tyre për politizimin e rolit të Kishës Ortodokse Serbe në Kosovë. Për shqiptarët e Kosovës ekziston një perceptim se KOS punon në rrënimin e shtetësisë së Kosovës dhe promovon ndarje. Megjithatë, pjesëmarrësit shprehën gatishmërinë ndaj dialogut ndërfetar dhe kjo mund të jetë një fushë për bashkëpunim të mundshëm.

---

7 Raporti i Shoqërisë Civile për të Drejtat e Njeriut, <https://newsocialinitiative.org/civil-society-report-on-human-rights-in-kosovo-in-2022/>; Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE), “Mbrojtja e Trashëgimisë Kulturore në Kosovë” 18 korrik 2022 <https://www.osce.org/mission-in-kosovo/522892>

## 3.4 Ekonomia

Bashkëpunimi ekonomik ndërmjet komuniteteve shqiptare dhe serbe në Kosovë mbetet i kufizuar, edhe pse ka pasur disa shembuj pozitivë të bashkëpunimit në biznes. Megjithatë, ekonomia në hïje në zonat me shumicë serbe, veçanërisht në veri të Kosovës, paraqet një sfidë të rëndësishme për zhvillimin ekonomik. Përpjekjet e qeverisë së Kosovës për të luftuar krimin e organizuar dhe informalitetin shpesh janë ndeshur me rezistencë, pasi këto veprime janë perceptuar nga serbët lokal si përpjekje për të minuar autonominë e tyre. Mungesa e policëve serbë të Kosovës në operacione të tilla dhe përdorimi i njësive të specializuara policore kanë rritur më tej tensionet, duke përforcuar perceptimin se masat për sundimin e ligjit janë të motivuara politikisht.

Energjia është një çështje tjeter e diskutueshme. Subvencionimi i vazhdueshëm i energjisë elektrike për veriun e Kosovës nga qeveria e Kosovës ka krijuar zhgënjin tek komuniteti shqiptar i Kosovës, të cilët e shohin atë si një barrë të padrejtë financiare. Megjithatë, është bërë përparim në dialogun e lehtësuar nga BE-ja dhe integrimi i sektorit të energjisë në veri të Kosovës është në zhvillim e sipër. Kompleksi i minierave Trepça/Trepça, dikur shihej si një gjigant ekonomik, ka qenë një burim grindjesh, ku si shqiptarët e Kosovës ashtu edhe serbët e Kosovës fajësojnë njëri-tjetrin për rënien e tij.

Një çështje kyçe e ngritur nga komuniteti serb i Kosovës është mungesa e perceptuar e investimeve publike në komunat me shumicë serbe. Hulumtimet e pavarura kanë treguar se investimet për kokë bnori në këto zona janë më të ulëta se në bashkitë me shumicë shqiptare, megjithëse arsyet për këtë pabarazi mund të ndryshojnë. Ky perceptim i neglizhencës ka nxitur pakënaqësi dhe ka dekurajuar pjesëmarrjen e serbëve të Kosovës në ekonominë e Kosovës. Siç vuri në dukje një ekspert, "Ka mungesë të një vizioni ekonomik për të gjithë vendin përfshirë edhe komunitetet jo-shumicë." Pa strategji të synuara ekonomike, zonat me shumicë serbe do të vazhdojnë të mbeten prapa.

Fondi i Zhvillimit për veriun e Kosovës, i krijuar përmes dialogut të lehtësuar nga BE-ja, ofron një mekanizëm të rëndësishëm për promovimin e zhvillimit ekonomik në zonat me shumicë serbe. Megjithatë, ndikimi i tij ka qenë i kufizuar dhe rezultatet janë të përfaqësuar në mënyrë të pamjaftueshme në mediat e Kosovës. Forcimi i dukshmërisë dhe llogaridhënieve së këtij fondi, si dhe sigurimi që investimet publike të shpërndahen në mënyrë të barabartë, mund të ndihmojë në adresimin e disa prej pabarazive ekonomike dhe të inkurajojë bashkëpunim më të madh ndërmjet bizneseve shqiptare dhe serbe të Kosovës.

Gjithashtu kishte shenja se Qeveria e Kosovës synonte të keqpërdorte Fondin Zhvillimor për Veriun duke i kthyer fondet për të mbuluar borxhin e akumuluar të energjisë elektrike të shkaktuar nga mospagesa nga banorët vendas. Megjithatë, kjo lëvizje u dënuar nga BE.

Aktualisht, çështja kryesore me Fondin Zhvillimor është se për shkak të ndalimit të importit të mallrave nga Serbia që ishte në fuqi për mbi 15 muaj, Fondi ka krijuar shumë pak të ardhura. Edhe pse Qeveria e Kosovës është pajtuar për heqjen e ndalimit të importit në një pikë kufitare, Merdare, është e rëndësishme të theksohet se ky vendkalim nuk është në veri të Kosovës. Siç u përmend më herët, kjo do të thotë se fondet e grumbulluara nga importi i mallrave ende nuk janë alokuar në Fondin Zhvillimor për Veriun, duke e privuar më tej rajonin nga burimet thelbësore financiare.

Kjo në mënyrë indirekte ka penguar zhvillimin e rajonit, pasi fondet mund të ishin përdorur për projekte që synojnë përmirësimin e cilësisë së jetës së banorëve në veri.

Pjesëmarrësit e diskutimit në fokus-grup me komunitetin shqiptar të Kosovës theksuan se mundësitetë ekonomike për shqiptarët e Kosovës dhe serbët e Kosovës nuk janë të barabarta. Shteti serb luan një rol të rëndësishëm në mbështetjen e jetesës ekonomike të serbëve të Kosovës, gjë që shton një shtresë tjetër të ndërlíkueshmërisë. Pjesëmarrësit e diskutimit në fokus grup vunë në dukje se ata besojnë se ekziston frika e diskriminimit dhe bojkotit që i pengon disa nga fillimi i bizneseve në zonat me popullatë shumicë shqiptare ose serbe. Si pjesë e një fushate më të gjerë për të bojkotuar mallrat serbe, ka pasur një efekt të përhapur që ka ndikuar edhe tek prodhuesit serbë të Kosovës. Veçanërisht, bizneset si Veraria Lakiçeviq dhe Birraria Pivdhan nuk kanë qenë në gjendje të plasojnë produktet e tyre në zonat me shumicë shqiptare, duke kufizuar aksesin e tyre në treg dhe duke izoluar më tej mundësitetë e tyre ekonomike.

Megjithatë, në disa komuna me shumicë serbe, si Graçanica/Gračanica dhe Shtërpca/Štrpcë, ka raste të bashkëpunimit të biznesit, siç janë bizneset shqiptare që hapin dyqane dhe shqiptarët që punojnë në biznese në pronësi serbe.

Në fokus grupin me komunitetin serb të Kosovës, pjesëmarrësit theksuan se qeveria në mënyrë sistematike krijon kushte të pafavorshme për bizneset serbe të Kosovës, veçanërisht në veri të Kosovës. Ata theksuan se vendimet politike (ndlalimi i importit të mallrave serbe; Rregullorja e Bankës Qendrore të Kosovës për operacionet me para të gatshme) shpesh i dobësojnë këto biznese dhe përfundimisht mund të çojnë në mbylljen e tyre duke promovuar njëkohësisht hapjen e bizneseve shqiptare në rajon.

# 04 Fushat me potencial për të avancuar me integrim konstruktiv

Për të ecur përpara, qasja e Kosovës për të nxitur integrimin konstruktiv në sektorët e arsimit, shëndetësisë, kulturës dhe ekonomisë duhet të bazohet në një strategji të qartë që thekson gjithëpërfshirjen, ndërtimin e besimit dhe zhvillimin e qëndrueshëm. Këta sektorë janë thelbësorë për marrëdhëniet ndëretnike ndërmjet komuniteteve shqiptare dhe serbe të Kosovës, me potencial për të nxitur bashkëpunimin lokal dhe integrimin më të gjerë shoqëror në Kosovë. Adresimi i këtyre sfidave kërkon një qasje të shumanshme që harmonizon politikat e qeverisë, iniciativat e shoqërisë civile dhe kontributet e sektorit privat.

## 4.1 Trashëgimia Kulturore dhe Fetare

Një nga sfidat kryesore për marrëdhëniet ndëretnike në Kosovë është perceptimi i trashëgimisë kulturore dhe fetare nga komuniteti serb i Kosovës. Ekziston një nevojë urgjente përfundimtari publik për të informuar të gjithë qytetarët, veçanërisht komunitetin serb të Kosovës, rreth mbrojtjeve që ofron legjislacioni i Kosovës dhe Plani i Ahtisarit në lidhje me trashëgiminë kulturore dhe fetare. Rritja e ndërgjegjësimit të publikut për këto të drejta është thelbësore përfundimtari për larguar frikën se këto vende mund të negligohen ose përvetësohen nga shumica shqiptare e Kosovës.

Masë kyçë përfundimtari e besimit do të ishte që qeveria e Kosovës dhe liderët i saj politik të adopton një qasje më të kujdeshme në diskutimet publike lidhur me trashëgiminë kulturore dhe fetare serbe. Perceptimi i përvetësimit nga komuniteti shqiptar ka qenë burim tensioneve, dhe shmangia nga një retorikë e tillë mund të reduktojë ndjeshëm keqkuptimet dhe mosbesimin.

Për më tepër, organet e zbatimit të ligjit duhet të luajnë një rol proaktiv në mbrojtjen e objekteve kulturore dhe fetare serbe. Individët e përfshirë në vandalizëm ose dhunë që cak i kanë këto vende e objekte duhet të përballen me pasoja ligjore. Një kornizë e fuqishme ligjore, e mbështetur nga zbatimi efektiv i ligjit, do të forconte mbrojtjen e trashëgimisë së pakicave dhe do të përforconte perceptimin se këto vende vlerësohen si pjesë e identitetit të larmishëm të Kosovës.

## 4.2 Integrimi Ekonomik

Sektori privat ofron një shteg të rëndësishëm përfundimtari e tejkalimin e hendekut ndërmjet komunitetit shqiptar dhe atij serb të Kosovës. Megjithatë, që integrimi ekonomik të jetë efektiv, duhet të ketë mbështetje më të madhe përfundimtari projektet ekonomike ndëretnike që përfshijnë aktivisht komunitetet joshumicë, veçanërisht në zonat me shumicë serbe. Kjo kërkon një vizion më gjithëpërfshirës të zhvillimit ekonomik që pranon kontributet e komuniteteve joshumicë si jetike përfundimtari e përgjithshme të Kosovës.

Strategjia e ardhshme Kombëtare për Zhvillim-2030 paraqet një mundësi për të inkorporuar masa specifike që synojnë adresimin e nevojave zhvillimore të komuniteteve joshumicë, duke siguruar që komunat me shumicë serbe të mos mbeten prapa. Një rishikim i plotë i investimeve publike në këto fusha është i nevojshëm për të identifikuar mangësitë dhe për të rritur mundësitë për zhvillim ekonomik. Kjo jo vetëm që do të reduktonte pabarazitë ekonomike, por gjithashtu do të nxiste një ndjenjë të prosperitetit të përbashkët përtëj linjave etnike.

Për më tepër, sektori i TIK-ut në Kosovë, i cili ka përjetuar rritje të konsiderueshme, ka potencial të rëndësishëm për bashkëpunim me komunat me shumicë serbe. Duke inkurajuar partneritetet në këtë sektor, Kosova mund të përdorë teknologjinë për të promovuar bashkëpunimin ndëretnik, për të krijuar vende pune dhe për të integruar komunat me shumicë serbe në ekonominë kombëtare.

Reduktimi i ekonomisë në hije dhe informalitetit në komunat me shumicë serbe është gjithashtu thelbësor. Sfidë mbetet integrimi në sistemin fiskal, por kjo mund të trajtohet nëpërmjet programeve nxitëse që inkurajojnë bizneset në këto fusha të formalizojnë veprimtarinë e tyre. Qeveria gjithashtu duhet të ndërmarrë hapa për të shfuqizuar ndalesat diskriminuese, siç është ndalimi i importit të mallrave serbe, që pengon integrimin dhe bashkëpunimin ekonomik. Adresimi i çështjeve të tilla me një qasje më proaktive do të ndihmojë në ndërtimin e besimit dhe përmirësimin e marrëdhënieve ekonomike ndërmjet komuniteteve.

Qeveria e Kosovës duhet të marrë një qasje proaktive duke denoncuar fushatat diskriminuese që avokojnë për bojkotimin e produkteve serbe të importuara nga Serbia. Në të njëjtën kohë, duhet të punohet për të rritur dukshmërinë dhe qasjen në treg të produkteve të prodhuara nga serbët e Kosovës brenda Kosovës. Për më tepër, qeveria duhet të adresojë sfidat me të cilat përballen qytetarët e Serbisë në Kosovë për shkak të Rregulloreve të vendosura nga Banka Qendrore e Kosovës, duke u siguruar që këto rregullore të zbatohen në mënyrë të drejtë dhe gjithëpërfshirëse.

Pjesëmarrësit e diskutimit në fokus grup me komunitetin shqiptar të Kosovës sugjeruan se nxitja e sipërmarrjeve të përbashkëta ekonomike, veçanërisht në sektorë si teknologjia apo shëndetësia, ku bashkëpunimi ndëretnik tashmë ekziston në një masë të kufizuar, mund të ndihmojë në uljen e mosbesimit dhe promovimin e integrimit më të madh. Sigurimi i informacionit dhe mbështetjes më të mirë për sipërmarrje të tilla është thelbësor.

## 4.3 Arsimi

Sektori i arsimit mbetet një nga fushat më të ndjeshme për integrimin e komunitetit serb të Kosovës. Ekziston nevoja për të përcaktuar qartë se çfarë përfshin integrimi i shkollave që mësimin e mbajnë në gjuhën serbe në sistemin arsimor të Kosovës, veçanërisht për të siguruar komunitetin serb të Kosovës se integrimi nuk nënkupton humbje të identitetit kulturor apo gjuhësor. Shkollat duhet të ruajnë plan programet e tyre, tekstet shkollore dhe punësimin e mësimdhënësve serb dhe kjo duhet të komunikohet në mënyrë eksplikite për të larguar çdo shqetësim.

Për të lehtësuar këtë proces, aktorët ndërkombëtarë si BE-ja mund të luajnë një rol kyç në

vlerësimin e plan programeve aktuale të përdorura në shkollat ku mësimi mbahet në gjuhën serbe. Shqyrtimi i matur dhe bashkëpunues mund të identifikojë problemet herët, duke parandaluar konfliktet e panevojshme dhe duke siguruar integrim të qetë. Përveç kësaj, shkollat me mësim në gjuhën serbe duhet të inkurajohen që të angazhohen me Ministrinë e Arsimit të Kosovës për të raportuar mbi plan programet dhe të dhënat e regjistrimit të nxënësve. Të dhënat e sakta janë thelbësore për alokimin e barabartë të burimeve nga buxheti i Kosovës për këto shkolla, duke siguruar që ato të marrin financimin dhe mbështetjen që u nevojitet.

Sfidë kritike, ashtu si në sektorin e shëndetësisë, është themelimi i Asociacionit/Bashkësisë së Komunave me shumicë serbe. Ky mekanizëm ndërmjetës është thelbësor për të siguruar një proces integrues paqësor dhe të rregullt.

Një aspekt tjetër kyç i integrimit arsimor është nevoja për njohje të ndërsjellë të diplomave ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. Kjo ka qenë një pikë mosmarrëveshjeje për vite me rradhë, por mbetet jetike për të mundësuar mobilitet dhe mundësi punësimi për studentët nga të dy komunitetet. BE-ja duhet të vazhdojë për ta shtyrë zbatimin e plotë të Udhëzuesit të BE-së së vitit 2011 për njohjen e diplomave, duke siguruar që studentët nga komunat me shumicë serbe të mund të ndjekin mundësitë si në Kosovë ashtu edhe në Serbi pa pengesa burokratike. Themelimi i Universiteti në Mitrovicën e Veriut, në përputhje me kornizën ligjore të Kosovës, do të sinjalizonte gjithashtu një hap pozitiv drejt përmirësimit të qasjes në arsimin e lartë për komunitetin serb të Kosovës.

## 4.4 Shëndetësia

Integrimi i sistemit shëndetësor kërkon një qasje të kujdeshme që merr parasysh privilegjet ekzistuese dhe qasjen që gjëzon komuniteti serb i Kosovës. Qeveria e Kosovës duhet të përcaktojë qartë se çfarë do të thotë integrim shëndetësor, duke siguruar komunitetin serb të Kosovës se ata do të vazhdojnë të përfitojnë nga shërbimet cilësore pa ndërprerje. Në të njëjtën kohë, përmirësimi i cilësisë së përgjithshme të kujdesit shëndetësor publik në Kosovë, duke përfshirë mundësinë për të ofruar shërbime në gjuhën serbe, është vendimtar për ndërtimin e besimit dhe inkurajimin e integrimit.

Për të zhvilluar një plan efektiv integrimi, qeveria duhet së pari të sigurojë se ka informacion të saktë dhe të përditësuar mbi gjendjen e kujdesit shëndetësor në komunat me shumicë serbe, duke përfshirë numrin e mjekëve, infermierëve dhe gjendjen e kujdesit shëndetësor objekteve të kujdesit shëndetësor. Ky informacion është thelbësor për planifikimin dhe formulimin e politikave. BE-ja, si pjesë e rolit të saj lehtësues në dialogun Kosovë-Serbi, mund të ndihmojë duke bërë vlerësimin e sistemit të kujdesit shëndetësor në këto komuna, duke siguruar që çdo përpjekje drejt integrimit të bazohet në një kuptim real të nevojave aktuale.

Bashkëpunimi i mëtutjeshëm ndërmjet Kosovës dhe Serbisë në sektorin e kujdesit shëndetësor mund të jetë reciprokisht i dobishëm, veçanërisht duke pasur parasysh ballafaqimin e rajonit me humbje në rritje të talenteve në shëndetësi. Një qasje bashkëpunuese për trajnimin dhe mbajtjen e profesionistëve të kujdesit shëndetësor mund të jetë e dobishme si në Kosovë ashtu edhe në komunat me shumicë serbe. Sigurimi i rrjedhës

së pandërprerë të furnizimeve mjekësore nga Serbia në institucionet shëndetësore serbe në Kosovë është gjithashtu jetike për ruajtjen e besimit dhe ofrimin e kujdesit adekuat. Integrimi konstruktiv në sektorët e arsimit, shëndetësisë, kulturës dhe ekonomisë është thelbësor për ndërtimin e një shoqërie kohezive dhe multietnike në Kosovë. Duke ndërmarrë veprime të synuara — të rrënjosura në transparencë, gjithëpërfshirje dhe respekt për identitetin kulturor — qeveria e Kosovës mund të forcojë bashkëpunimin ndëretnik dhe të përmirësojë integrimin e përgjithshëm shoqëror të serbëve të Kosovës. Secili sektor paraqet sfida unike, por me mbështetjen e palëve kryesore të interesit, duke përfshirë BE-në, mund të arrihet përparim në sigurimin që komuniteti shqiptar dhe serb i Kosovës të ndihen të vlerësuar dhe të përfaqësuar në mënyrë të barabartë në të ardhmen e Kosovës.


# 05 Perceptimet e integrimit konstruktiv, të shprehur në numra

Pas dy diskutimeve në fokus grupe me komunitetin shqiptar dhe serb të Kosovës, ne ndamë me ta një pyetësor për të mbledhur disa të dhëna kuantitative në lidhje me perceptimet e tyre për integrimin e serbëve të Kosovës në sektorët kyç - arsim, shëndetësi, ekonomi dhe trashëgimi kulturore. Rezultatet paraqesin një pasqyrë interesante të marrëdhënieve ndëretnike në Kosovë, duke nënvizuar nevojën për ndërhyrje të synuara të politikave që adresojnë boshllëqet në shërbime dhe mundësi, duke nxitur mirëkuptimin dhe bashkëpunimin reciprok. Këtu është analiza gjithëpërfshirëse, e përshtatur në një tregim të qëndrueshëm:


## 5.1 Arsimi: Sistem që konsiderohet që çalon në cilësi dhe gjithëpërfshirje

Anketa tregon pakënaqësi me cilësinë e arsimit në të dy komunitetet. Kur u pyetën për të vlerësuar cilësinë e arsimit, 60% e shqiptarëve të Kosovës dhe 50% e serbëve të Kosovës e vlerësuan atë si "të dobët", ndërsa 40% e shqiptarëve të Kosovës dhe 25% e serbëve të Kosovës e vlerësuan atë si "të kënaqshme." Vetëm 25% e serbëve të Kosovës i dhanë sistemit një vlerësim pozitiv ("Mirë"), ndërsa asnjë shqiptar i Kosovës nuk e vlerësoi atë më lart se "e kënaqshme." Këto rezultate sugjerojnë që të dy komunitetet e perceptojnë sistemin arsimor si të mangët në ofrimin e arsimit cilësor, me një pikëpamje paksa më të favorshme nga komuniteti serb i Kosovës. Kur bëhet fjalë për përfshirjen, ka një ndarje të dukshme. Të gjithë shqiptarët e Kosovës të anketuar (100%) besojnë se sistemi arsimor nuk është gjithëpërfshirës, krahasuar me vetëm 50% të serbëve të Kosovës që ndajnë mendim të njëjtë. Gjysma tjetër e të anketuarve serbë të Kosovës besojnë se sistemi është gjithëpërfshirës, duke treguar për përvojat divergjente ndërmjet komuniteteve. Ky boshllëk sugjeron se përderisa disa serbë të Kosovës përjetojnë përfshirje, shqiptarët e Kosovës në masë të madhe e perceptojnë sistemin si përjashtues. Kjo do të thotë se ata nuk e ndjejnë se sistemi arsimor në Kosovë është i gatshëm të ketë diversitet. Përderisa ka raste, veçanërisht në jug të Kosovës, ku nxënësit shqiptarë e serbë të Kosovës shkojnë në të njëjtën ndërtësë shkolle, hapësirat janë të ndara fizikisht, një sistem i quajtur "dy shkolla nën një çati", një koncept që përdoret dukshëm për të treguar segregacionin në Bosnje dhe Hercegovinë.

Si do ta vlerësonit cilësinë e arsimit  
në komunitetin tuaj?




A besoni se sistemi arsimor është  
gjithëpërfshirës për të gjitha komunitetet?




## 5.2 Shëndetësia: I disponueshëm, por jo i qëndrueshëm në cilësi

Shërbimet e kujdesit shëndetësor shfaqen gjithashtu si një fushë shqetësuese, megjithëse perceptimet për cilësinë ndryshojnë midis komuniteteve. Përderisa 20% e shqiptarëve të Kosovës dhe serbëve të Kosovës e vlerësuan kujdesin shëndetësor si "të dobët", shumica e të anketuarve nga të dyja komunitetet e vlerësuan atë si "të kënaqshme" (80% e shqiptarëve të Kosovës dhe 50% e serbëve të Kosovës). Është interesante se 30% e serbëve të Kosovës i vlerësuan shërbimet e kujdesit shëndetësor si "të mira", duke treguar një përvojë më pozitive në krahasim me shqiptarët e Kosovës, ku asnjëri prej të tyre nuk i vlerësoi shërbimet mbi "të kënaqshme". Sa i përket disponueshmërisë, 40% e shqiptarëve të Kosovës dhe 60% e serbëve të Kosovës mendojnë se kujdesi shëndetësor është i disponueshëm për të gjithë në komunitetin e tyre. Megjithatë, një pjesë e konsiderueshme e të dy grupeve — 60% e shqiptarëve të Kosovës dhe 40% e serbëve të Kosovës — ende mendojnë se shërbimet e kujdesit shëndetësor nuk janë të disponueshme në mënyrë të barabartë. Kjo tregon se përderisa edhe pse më shumë serbë të Kosovës raportojnë qasje më të mirë në kujdesin shëndetësor, sfidat mbeten në sigurimin që shërbimet të arrijnë të gjithë anëtarët e komunitetit në mënyrë të barabartë.

Si do ta vlerësonit cilësinë e shërbimeve të kujdesit shëndetësor në komunitetin tuaj?




A mendoni se shërbimet e kujdesit shëndetësor janë të disponueshme për të gjithë në komunitetin tuaj?



## 5.3 Trashëgimia Kulturore: Një shqetësim i përbashkët

Një fushë ku shqiptarët e Kosovës dhe serbët e Kosovës puqenështë rëndësia që ata i kushtojnë trashëgimisë kulturore dhe fetare. Çdo i anketuar—100% e shqiptarëve të Kosovës dhe serbëve të Kosovës—ka treguar se trashëgimia kulturore është "e rëndësishme" përtatë. Kjo vlerë e përbashkët sugjeron se pavarësisht sfidave të shumta me të cilat përballen komunitetet, trashëgimia kulturore mund të shërbejë si një bazë e përbashkët përxitjen e dialogut dhe bashkëpunimit. Megjithatë, kur u pyetën nëse ndjejnjë se trashëgimia e tyre kulturore respektohet dhe mbrohet, shumica dërrmuese e të dy komuniteteve u përgjigjë negativisht. Në mesin e shqiptarëve të Kosovës, 80% thanë "Jo", dhe 100% e serbëve të Kosovës shprehën të njëjtën mendim. Kjo ndjenjë e përhapur e neglizhencës ose mosrespektimit ndaj trashëgimisë kulturore është një burim potencial tensioni, por gjithashtu thekson një mundësi për qeverinë në Kosovë dhe palët e tjera të interesuara që t'i adresojnë këto shqetësimë përmes iniciativave më të fuqishme.




## 5.4 Mundësitë ekonomike: Një burim i madh i frustrimit


Mundësitë ekonomike — ose mungesa e tyre — janë një pikë e rëndësishme e pakënaqësisë, veçanërisht në mesin e serbëve të Kosovës. Përderisa 80% e shqiptarëve të Kosovës i vlerësuan mundësitë ekonomike si "të drejta" dhe 20% si "të mira", tabloja është shumë më e zymtë për serbët e Kosovës. Një 75% mbresëlënëse e serbëve të Kosovës i vlerësuan mundësitë ekonomike si "të dobëta", me vetëm 12.5% secili i vlerësoi ato si "të kënaqshme" ose "të mira". Ky kontrast i mprehtë sugjeron se serbët e Kosovës ndihen shumë më të marginalizuar ekonomikisht sesa shqiptarët e Kosovës, duke reflektuar pabarazi më të gjera strukturore që prekin në mënyrë disproporcionale komunitetet pakicë në Kosovë. Kur u pyetën nëse ka mundësi të barabarta ekonomike përfshirë gjitha komunitetet, 80% e shqiptarëve të Kosovës dhe 100% e serbëve të Kosovës thanë "Jo". Ky unanimitet në perceptim nxjerr më pah pabarazinë ekonomike si një pengesë kryesore përintegrimin, me të dy komunitetet që pranojnë nevojën përfshirë një shpërndarje më të barabartë të burimeve dhe mundësive.

Rezultatet e anketës hedhin dritë mbi sfidat kritike me të cilat përballet integrimi i serbëve të Kosovës në shoqërinë kosovare por dhe shfaqen disa tema kryesore. Të dy komunitetet raportojnë pakënaqësi me cilësinë e arsimit dhe kujdesit shëndetësor. Kjo tregon se përpjekjet përfshirësimin e shërbimeve publike do të shkonin në dobi si përfshirët e Kosovës ashtu edhe përsimbën e Kosovës, duke ndihmuar më kapërcimin e disa boshillëqeve

**Si do t'i vlerësonit mundësitë ekonomike  
në komunitetin tuaj?**



**A besoni se ekzistojnë mundësi të barabarta ekonomike  
për të gjitha komunitetet?**



në cilësinë e jetës që pengojnë integrimin. Perceptimi i aksesit të pabarabartë në mundësitë ekonomike, kujdesin shëndetësor dhe arsimin është një pengesë kryesore për integrimin. Serbët e Kosovës, në veçanti, ndihen të marginalizuar ekonomikisht dhe të dy komunitetet e pranojnë se sistemi nuk po ofron mundësi të barabarta. Pavarësisht dallimeve në fusha të tjera, si shqiptarët ashtu edhe serbët e Kosovës i kushtojnë një vlerë të lartë trashëgimisë së tyre kulturore. Ky prioritet i përbashkët ofron një pikë hyrëse të mundshme për dialog dhe bashkëpunim dhe përmes e ndërtimit të besimit. Përqendrimi në mbrojtjen dhe promovimin e trashëgimisë kulturore, i lejon qeverisë së Kosovës të nxise bashkëpunimin ndëretnik që mund të tejkalojë ndarjet politike

Gjetjet tregojnë nevojën për politika që shkojnë përtej ofrimit të shërbimeve dhe zhvillimit ekonomik. Gjithëpërfshirja duhet të jetë në qendër të përpjekjeve të integrimit konstruktiv, për të sigruar që komunitetet pakicë si serbët e Kosovës të ndjehen të vlerësuar dhe të përfshirë në mënyrë të barabartë në kornizën më të gjerë shoqërore të Kosovës. Kjo përfshin adresimin e perceptimeve të rrënjosura thellë të përjashtimit që kanë të dy komunitetet.

# 06 Konkluzionet

Si përfundim, sfida e integrimit të komunitetit serb të Kosovës ilustrohet qartë nga ndjenja e "dy botëve të ndara që jetojnë në të njëjtin territor." Ky citat përmblehd segregacionin e rrënjosur thellë që përshkon sektorë kyç si arsimi, kujdesi shëndetësor dhe trashëgimia kulturore. Pavarësisht se janë gjeografikisht të afërta, këto komunitete mbeten të ndara shoqërisht dhe politikisht, duke e bërë integrimin kuptimplotë një detyrë komplekse.

Një nga barrierat më të kuptimplotë për përparimin është trauma e pa zgjidhur e së kaluarës. Siç vuri në dukje një pjesëmarrës, "Trauma e së kaluarës... njerëzit menjëherë kalojnë në gjendjen e mbijetesës, këto trauma nuk janë zgjidhur." Kjo pasqyron plagët emocionale dhe psikologjike që vazhdojnë të ndikojnë në marrëdhëni ndëretnike, duke parandaluar që përpjekjet për ndërtimin e besimit dhe pajimin të zënë rrënje.

Për të ecur përpara, ekziston një nevojë urgjente për t'i "dhënë fund termit "ata" midis komuniteteve. Pjesëmarrësit theksuan rëndësinë e përmirësimit të njohurive gjuhësore dhe nxitjes së bashkëpunimit ndëretnik, veçanërisht në kujdesin shëndetësor, ku ndërveprimi më i madh ndërmjet mjekëve shqiptarë dhe serbë të Kosovës mund të ndihmojë në rrënimin e barrierave. Adresimi i këtyre çështjeve përmes politikave të synuara, iniciativave ndërkomuniteteve dhe dialogut të qëndrueshëm do të jetë vendimtar për nxitjen e një shoqërie më kohezive dhe multietnike në Kosovë.

Integrimi i komunitetit serb të Kosovës në sektorët kyç — arsimi, shëndetësia, trashëgimia kulturore dhe ekonomia — përballet me sfida thelbësore të rrënjosura në ndjeshmërinë politike, mungesën e koordinimit dhe mosbesimin e thellë.


Në arsim, integrimi i shkollave që mësimin e mbajnë në gjuhën serbe në sistemin e Kosovës pengohet nga shqetësimet praktike dhe politike, duke përfshirë mungesën e bashkëpunimit ndërmjet autoriteteve arsimore të Serbisë dhe të Kosovës dhe frikën e komunitetit serb të Kosovës rreth ndryshimeve të mundshme të plan programeve dhe sigurisë së vendeve të punës së mësimdhënësve. Këta faktorë kanë përforcuar segregacionin dhe kanë penguar përpjekjet drejt një sistemi arsimor gjithëpërfshirës.

Shëndetësia paraqet një dinamikë pak më të ndryshme, ku sektori privat shëndetësor ofron shembuj të rrallë të bashkëpunimit ndëretnik. Megjithatë, vazhdimësia e sistemeve paralele të kujdesit shëndetësor, ku komuniteti serb i Kosovës mbështetet në shërbimet e ofruara nga Serbia, e izolon më tej komunitetin. Besimi në sistemin e shëndetësisë publike të Kosovës mbetet i ulët, dhe pa një bashkëpunim dhe ndërtim më të madh të besimit, integrimi i kujdesit shëndetësor do të mbetet i pakapshëm.

Në fushën e trashëgimisë kulturore, mbrojtja e objekteve të Kishës Ortodokse Serbe është një çështje e ngarkuar politikisht dhe e diskutueshme. Edhe pse korniza ligjore e Kosovës garanton mbrojtjen e trashëgimisë kulturore serbe, zbatimi ka qenë jokonsistent, duke çuar në mosmarrëveshje të vazhdueshme dhe duke nxitur mosbesim ndërmjet komuniteteve. Politizimi i mbrojtjes së trashëgimisë kulturore ka penguar përpjekjet për të depolitizuar këtë zonë kritike dhe për të nxitur një bashkëpunim më të madh.

Dhe së fundi, në ekonomi, integrimi mbetet i kufizuar, ku komunat me shumicë serbe varen shumë nga punësimi në sektorin publik dhe nga ekonomitë joformale. Përderisa tregtia ndërmjet Kosovës dhe Serbisë vazhdon, ajo nuk është transformuar në bashkëpunim ekonomik kuptimplotë në nivel komuniteti. Përpjekjet për të reduktuar ekonominë në hije dhe për të inkurajuar bashkëpunimin e biznesit ndëretnik janë përballur me rezistencë, duke rrënjosur më tej ndarjet ekonomike.

Në përgjithësi, integrimi i komunitetit serb të Kosovës kërkon përpjekje të vazhdueshme që shkojnë përtej kornizës ligjore. Integrimi konstruktiv duhet të ndërtohet mbi masat e ndërtimit të besimit, koordinimin me aktorët ndërkombëtarë dhe konsultimin kuptimplotë me komunitetet lokale për të trajtuar mosbesimin e thelluar dhe barrierat praktike që vazhdojnë të pengojnë progresin.



[newsocialinitiative.org](http://newsocialinitiative.org)



[qkss.org](http://qkss.org)